

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues Beqir Halili, me procesmbajtësen Zyla Tahiri, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDAKTUE], për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i te drejtës se votimit nga nen 216 par 1 pikë 1.2 te KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.127/2014 të datës 24.06.2015, të cilën e përfaqëson Prokurori Njazi Rexha, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 22.05.2017, të njëjtën ditë në prezencën e të akuzuarit [REDAKTUE], mbrojtësit të tij av. Sabit Pllana, e në mungese të prokurorit Njazi Rexha, e shpalli, kurse me datën 07.06.2017, e përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

### I akuzuari:

[REDAKTUE], i biri i [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE], e gjinisë [REDAKTUE], i lindur me datën [REDAKTUE] ne [REDAKTUE] ku edhe jeton në rrugën “[REDAKTUE]” pn., me numër personal [REDAKTUE] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i një fëmije, ka te kryer shkollën e mesme teknike, i pa pune, i gjendjes se dobët ekonomike, me pare i pa gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedure për vepër tjetër penale.

## Ë S H T Ë F A J T O R

### SEPSE:

Më datën 03.11.2013, ne shkollën mesme te gjimnazit ne Skenderaj, ne zgjedhjet lokale ne vendvotimin nr. 2101X/05D, ka votuar si votues i rregullt e pastaj ka votuar ne shkollën e mesme teknike “Anton Qeta” ne Skenderaj si votues me kusht.

- Me ketë ka kryer vepër penale **Keqpërdorimi i te drejtës se votimit nga nen 216 par. 1 nënpar. 1.2 te KPRK-së.**

Duke u bazuar ne dispozitat e nenit 41, 45, 51, 73, 74 të KPRK-së, dhe nenit 365, 366, dhe 450 par 2.6 te KPP-së, e:

## G J Y K O N

**ME DENIM ME BURG**, ne kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili nuk do te ekzekutohet ne periudhën kohore prej një (1) viti, me kushte qe i akuzuari te mos kryeje vepër te re penale.

Obligohet i akuzuari qe ne emër te shpenzimeve te procedurës penale e ne emër te paushallit gjyqësor ta paguaj shumen prej pesëdhjete (50) Euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së formës së prerer të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Kërkesa pasurore juridike nuk ka pasur.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë PP.I.nr.127/2014 të datës 24.06.2015, kundër të akuzuarit [REDAKTUE] për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i të drejtës se votimit nga neni 216 par 1 pika 1.2 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit filletar i akuzuari e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet.

**Prokurori i shtetit Njazi Rexha në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit deklaroi:** Duke pasur parasysh se i akuzuari e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare në konsultim me mbrojtësin e në mbështetje me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës i propozoj gjykatës që t'ia pranojë fajësinë.

**Mbrojtësi i të pandehurit av. Sabit Pllana në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit deklaroi:** Duke marrë parasysh që i mbrojturi im edhe në seancën e parë dhe tanë është penduar dhe ka pranuar fajësinë, mbetem pranë asaj që ka thënë edhe më parë dhe kërkoi nga gjykata që t'i jep ndonjë vërejtje gjyqësore ose ndonjë dënim me kusht.

Kryetari i trupit gjykuar përcakton se e akuzuara e kuptoj natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë se me pranimin e fajësisë nuk do të mbahet shqyrtimi gjyqësor, nuk do të ketë të drejtë të propozoj prova si dhe të paraqes ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga ana e të akuzuarit pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori.

Me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit gjykatë si rrethana lehtësuese në vështrim të nenit 74 par. 3 nënparr. 3.3, 3.8, 3.10 e 3.11 të KPRK-së, i ka marrë se: i akuzuari për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin pasi që nuk është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, ka bashkëpunuar në mënyrë korrekte me gjykatën dhe organet e ndjekjes, i akuzuari e ka pranuar fajësinë, ka shfaqur keqardhje për veprën e kryer penale, është penduar se e ka kryer këtë vepër dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale.

Gjykata të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin e parashikuar me ligj pasi që për veprën penale Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së, parashihet dëni prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 51 par.1 dhe 2 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili nuk do të ekzekutohet në periudhën kohore prej një (1) viti, me kusht që e akuzuara të mos kryej vepër të re penale.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënit nga neni 41 par 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor.

Në bazë të të dhënave të shënuara si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi..

### GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.25/2017, me datën 07.06.2017

Procesmbajtësja,

Zyla Tahiri

Kryetari i trupit gjykuar

Beqir Halili

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh Gjykatës se Apelit në Prishtinë-Departamentit për krime të rënda, e përmes kësaj Gjykatë.